



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.98/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “KUR Mitrovica” ShA me numër fiskal 600338033 dhe seli në rrugën “Rruga e Liqenit” p.nr. në Mitrovicë kundër debitorit “BB HOME NEW” ShPK me NUI 810021692 dhe seli në rrugën Agim Ramadani Katana në Mitrovicë, i cili përfaqësohet në bazë të prokurës nga avokati F.SH. me seli në rrugën Ukshin Hoti 120, kati.I-C3/2/A në Prishtinë,, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë,Departamenti për Cështje Ekonomike KPPP.nr. 214/23 të datës 30.11.2023, me datën 18.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e kreditorit “KUR Mitrovica” ShA me seli në rrugën “Rruga e Liqenit” p.nr. në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Cështje Ekonomike KPPP.nr. 214/23 të datës 30.11.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 214/23 të datës 30.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “BB HOME NEW” ShPK, me seli në Mitrovicë, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 297/22, i lejuar më datë 29.12.2022, nga Përmbartuesi Privat Isa Shala, Përdundohet, dhe Detyrohet kreditorit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj debitorit shpenzimet

e procedurës në këtë gjykatë në shumë prej 208€, në emër të përpilimit të prapësimit përmes avokatit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën ka kërkuar që të refuzohet ankesa e kreditorit ndërsa aktvendimi KPPP.nr. 214/23 të datës 30.11.2023 i shkallës së parë të vërtetohet.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

**-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit, P.nr. 297/22, i lejuar më datë 29.12.2022, me të cilin ka lejuar përmbaremore me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori “BB HOME NEW” ShPK me seli në Mitrovicë, (këtu e tutje Debitori) që t’ia paguaj shumën prej 190.95€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore. Propozimin për përmbaremore e kishte bazuar në kartelën financiare të konsumatorit si ekstrakt i verifikuar nga librat e kontabilitetit për periudhën kohore nga 01.01.2021 deri 14.12.2022 të lëshuara nga Kreditori (këtu e tutje Ekstrakti), të cilin në origjinal ia ka bashkëngjitur Propozimit

Kundër urdhrit përmbaremore Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbaremore dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ai ka deklaruar se pretendimi i kreditorit është i pabazuar dhe si tillë nuk qëndron sepse shërbimi nuk është kryer nga Debitori, por nga blerësit e banesës. Në këtë drejtim ka argumentuar se, në bazë të kontratës LRP nr. rendor 3157/2021, nr. reference 800/2021, vërtetohet që Debitori nuk është pronar as zotëruar i asnjë interesi juridik në banesën lëndor ku pretendohet të jetë bërë faturimi. Tutje ka shtuar se në këtë çështje juridike, titulli juridik nuk është

i përshtatshëm për përmbardim, për shkak se nuk është bërë kryerja e shërbimit. Në këtë drejtim është thirrur në nenin 29 para. 3 të LPP-së, dhe gjithashtu është thirrur në nenin 6 të LMD-së, lidhur me ndalimin e keqpërdorimit të të drejtave, duke shtuar se paraqet precedent të rrezikshëm për funksionimin e bizneseve me mirëbesim, sepse palët, subjektet në një marrëdhënie juridike nuk duhet të bëjnë keqpërdorimin e të drejtave. Prapësimit i ka bashkëngjitur si provë kontratën mbi shitblerjen e banesës LRP nr. rendor 3157/2021, rr. reference 800/2021 të datës 07.04.2021, si dhe ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimit përmes avokatit në shumë prej 208€. Kreditori në përgjigjen e tij në Prapësim ka kërkuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar Prapësimi i Debitorit. Ai ka deklaruar propozimi për përmbardim është filluar në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstrakteve të verifikuar nga librat afarist, siç e parasheh LPP. Përgjigjes në prapësim nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur paraqitjen e përgjigjes në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se prapësimi është i bazuar. Nga shkresat e lëndës rezulton se se Kreditori ka nxjerrë ekstraktin në emër të Debitorit me numër K011107 për periudhën kohore 01.01.2021 deri 14.12.2022. Ai përmban të dhëna për Kreditorin dhe Debitorin, objektin, llojin dhe shumën e detyrimit monetar, por atij i mungon koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Gjithashtu, nga shkresat e lëndës nuk rezulton se Kreditori ka paraqitur deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe ditën për një gjë të tillë. Kjo situatë rregullohet në rend të parë me nenin 29 para. 3 të LPP-së, në bazë të cilit “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumën dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anën tjetër, neni 30 i LPP-së ka paraparë se “Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbardimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë”

Gjykata e shkallës e parë duke ju referuar këtyre dispozita rrjedhë se, për ta caktuar përmbardimin në bazë të dokumentit të besueshëm, ai duhet të jetë i hartuar në formën e kërkuar ligjore, në këtë rast ta përmbaj kohën e përmbushjes së detyrimit, qoftë në formë të datës fikse qoftë në formë të afatit, e në mungesë të kohës së përmbushjes, atëherë Kreditori e ka mundësinë ligjore që para se

të caktohet përbarimi të paraqes deklaratë me shkrim para organit të përbarimit në të cilin tregon kohën se kur është bërë e arritshme kërkesa e tij. Në rastin konkret, mungojnë të dy format e përcaktimit të kohës për përmbushjen e kërkesë që rrjedhë nga dokumenti i besueshëm, andaj si rezultat i mungesë së kohës së përmbushjes së detyrimit monetar në dokumentin e besueshëm vjen deri te mungesa e tipareve të përbarueshmërisë, gjegjësisht te papërshtatshmëria për përbarim e dokumentit të besueshëm. Për pasoj duhet të zbatohet neni 71 para. 1 nënpara. 1.1 të LPP-së, sipas të cilit “(...) prapësimi mund të bazohen vetëm nëse dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmërisë”.

Tutje për shkallwn e parw, mungesa e elementeve thelbësore në dokumentin e besueshëm paraqet pengesë të pakapërcyeshme ligjore, për shkak të cilës nuk mund të lejohet përbarimi. Meqenëse në këtë procedurë përbarimore nuk kishte çështje tjetër për tu trajtuar, atëherë gjykata vendosi ta përfundon procedurën në tërësi, siç përcakton nenit 73 para. 4 i LPP-së. Për më tepër, gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerësoi se nuk është e domosdoshme të caktohet seancën gjyqësore për ta kuptuar plotësisht validitein e Prapësimi, siç ka caktuar neni 73 para. 1 i LPP-së, meqë nga shkresat e lëndës gjendja faktike dhe juridike ishte qartë. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 para. 1 dhe 463 para. 1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Per latrtesin e shpenzimeve duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 para. 2 LPK-së lidhur me neni 17 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qarte se si dokument i besueshëm, për shkak se kreditori ka nxjerrë ekstraktin në emër të Debitorit me numër K011107 për periudhën kohore 01.01.2021 deri 14.12.2022. Ai përmban të dhëna për Kreditorin dhe Debitorin, objektin, llojin dhe shumën e detyrimit monetar, por atij i mungon koha e përmbushjes së detyrimit monetar. pra nuk është kërkesa e mjaftueshëm për përmbartim. Meqenëse në rastin konkret Propozimi përmban të metat e sqaruara më lartë, atëherë ai nuk është paraqitur në përputhje me kërkesat e LPP-së, rrjedhimisht në momentin e nxjerrjes së Urdhrit nuk ishin plotësuar kushtet për nxjerrjen e tij, për pasojë Përmbartuesi nuk e ka pasur të mundshme të nxjerrë Urdhrit. Andaj për shkallën e dytë mungesat e lartcekura në Propozim paraqesin pengesë të pakapërcyeshme ligjore, për shkak të cilave Urdhri në bazë të nenit 43 para. 4 të LPP-së duhet të përfundohet.

Andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkalles se Dytë

K.DH.SH.II nr.98/24, me datë 18.03.2024

Gjyqtari,

Saranda Bogaj Sheremeti